

**Jelena Llonçar** (Jelena Lončar)  
Fakulteti i Shkencave Politike  
Universiteti i Beogradit dhe University of York

## **Trashëgimia kulturore në Kosovë: nxitja e përjashtimit nëpërmjet legjislacionit inkluziv**

### **Abstrakt:**

Ky punim përqendrohet në marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë, duke analizuar procesin e miratimit të dy ligjeve për minoritetet: Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit dhe Ligjin për Fshatin Hoçë e Madhe. Duke përdorur metodën e analizës kritike kornizuese, në punim hulumtohet rrjedha e procesit legjislativ, mënyra e paraqitjes së çështjeve në rendin e ditës, e përfituesve prej ligjit si dhe e aktorëve të tjerë të përfshirë në procesin e përmendur. Gjetjet tregojnë se madje edhe legjislacioni i favorshëm për minoritetet mund të shërbejë si mekanizëm përjashtimi. Megjithëse korniza legjislative në Kosovë garanton mbrojtjen e plotë të të drejtave minoritare, institucionet politike kosovare i mbajnë gjallë ndarjet etnike dhe tensionet ndëretnike.

---

### **Fjalët kyçe:**

marrëdhëniet ndëretnike, trashëgimia kulturore, procesi legjislativ, Kosova.

Gjatë viteve të fundit, Kosova ka shënuar një përparim të rëndësishëm lidhur me çështjen e mbrojtjes së të drejtave minoritare. Mirëpo, përparimi i përmendur ka të bëjë veçanërisht me miratimin e legjislacionit të favorshëm, ndërkohë që zbatimi i tij vazhdon të jetë problematik. Kosova po lufton me shkeljen e përhapur gjerësisht të të drejtave minoritare dhe me tensione të larta ndëretnike. Një pjesë e madhe e teksteve, ku trajtohet çështja e mbrojtjes së të drejtave të pakicave në Kosovë, përqendrohet në kornizën institucionale, ndërsa procesi legjislativ sidomos mbi pakicat, nuk është shqyrtuar sa duhet. Ky punim sugjeron se është e nevojshme të analizohen proceset legjislative, mënyrat e paraqitjes së çështjeve në rendin e ditës dhe aktorët që marrin pjesë në to. Dëshiroj të shqyrtoj si rrjedh procesi legjislativ, si paraqiten çështjet e futura në rendin e ditës në parlament, si, kush dhe në ç'mënyrë merr pjesë në këtë proces. Kornizat dhe arsyetimi për pranimin e ligjeve të caktuara mund të na ndihmojnë të shpjegojmë boshllëkun midis detyrimeve ligjore për mbrojtjen e pakicave dhe zbatimin të tyre.

Duke u nisur nga ky qëllim, në punim shqyrtohet procesi i miratimit të dy ligjeve të rëndësishme për pakicat: Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit (në tekstin në vazhdim Ligji për Prizrenin) dhe Ligji për Fshatin Hoçë e Madhe (në tekstin në vazhdim Ligji për Hoçën e Madhe). I shfrytëzoj këto dy ligje për hapjen e çështjes më të gjerë të marrëdhënieve ndëretnike. Analiza dëshmon për natyrën komplekse të marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë dhe vë në pah se në ç'mënyrë madje edhe legjislacioni inkluziv mund t'i shërbejë përjashtimit të minoriteteve.

Struktura e punimit është si vijon: pjesa e parë shqyrton nivelin e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore të pakicave në Kosovë. Pjesa e dytë paraqet metodën e analizës kritike kornizuese (*critical frame analysis*, më tepër për të më poshtë në tekst) si metodë për hulumtimin e procesit legjislativ, ndërsa në pjesën e tretë paraqiten gjetjet. Analiza tregon se korniza, brenda të cilës janë paraqitur Ligji për Prizrenin dhe Ligji për Hoçën, është e pandashme nga korniza e kërcënimit dhe e pavarësisë dhe kjo mënyrë e interpretimit të çështjeve të rëndësishme për pakicat mund të ndikojë në rritjen e tensionit ndëretnik midis serbëve dhe shqiptarëve. Një argument i ngjashëm paraqitet në pjesën e katërt, e cila përqenrohet në përjashtimin e disa çështjeve dhe aktorëve të caktuar nga debati legjislativ. Në pjesën e pestë jepen konkluzionet e analizës.

### **Trashëgimia kulturore në Kosovë: legjislacioni në kontrast me implementimin**

Mbrojtja e objekteve kulturore dhe fetare në Kosovë është e garantuar me Kushtetutën e Kosovës, me Ligjin për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, me Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit dhe me Ligjin për Fshatin Hoçë e Madhe. Ligjet e përmendura garantojnë ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore e fetare, veçanërisht të “manastireve ortodokse serbe, kishave, objekteve të tjera fetare, si dhe objekteve historike e kulturore të një rëndësie të veçantë për komunitetin e serbëve të

Kosovës, si dhe për komunitetet tjera<sup>205</sup> në Republikën e Kosovës” (Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, 2008, neni 1).

Legjislacioni që ka të bëjë me trashëgiminë kulturore minoritare është pjesë e një plani më të gjerë për fuqizimin e multikulturalizmit në Kosovë, që është vënë si kusht kryesor për zgjidhjen e statusit përfundimtar të Kosovës. Kushti themelor para marrjes së vendimit për statusin përfundimtar të Kosovës ishte që institucionet kosovare të tregojnë gatishmëri dhe aftësi për të mbrojtur të drejtat e pakicave. Nevoja që të mbrohet trashëgimia kulturore e pakicave, e veçanërisht e objekteve fetare ortodokse, është pranuar në mënyrë eksplicite në Aneksin V të Planit të Ahtisarit. Në pajtim me Planin e Ahtisarit, Kuvendi i Kosovës që nga viti 2008 ka miratuar ligje dhe rregullore të shumta, të cilat ofrojnë garanci kyçe për mbrojtjen e të drejtave minoritare. Midis atyre që kanë të bëjnë me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, më të rëndësishmit janë Ligji për Prizrenin dhe Ligji për Hoçën e Madhe, të miratuara në vitin 2012. Ligji për Prizrenin dhe Ligji për Hoçën e Madhe kanë si qëllim rregullimin e mënyrës së themelimit dhe administrimit të zonave të veçanta të mbrojtura në komunat Prizren dhe Rahovec, por edhe mbrojtjen, promovimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore e fetare të këtyre zonave dhe parandalimin e zhvillimit urban, i cili në të ardhmen do të mund të ndikonte në këto vendbanime.

Megjithë ekzistencën e legjislacionit inkluziv dhe të favorshëm për minoritetet, ende ka incidente që përfshijnë rrënimin, plaçkitjen dhe vandalizmin e objekteve kulturore e fetare, veçanërisht të objekteve të trashëgimise kulturore serbe. Vihet re dukshëm mungesa e vazhdueshme e bashkëpunimit midis pushtetit lokal dhe qeverisë për zbatimin e këtyre ligjeve. Pushteti lokal në Prizren ose Rahovec e bojktojnë rregullisht ose e anashkalojnë zbatimin e këtyre ligjeve (Arraiza, 2014). Një problem themelor paraqesin ndërtimet pa leje rreth lokaliteteve të mbrojtura, shpesh i nxitur nga pushteti komunal (EC MA Ndryshe, 2013, OSBE, 2014).

Duke patur parasysh mungesën e zbatimit të ligjeve për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të pakicave, ky punim synon të hulumtojë mënyrat, me anë të të cilave janë aprovuar këto ligje, si dhe mënyrat se si janë paraqitur çështjet në rendin e ditës të parlamentit, përfituesit prej këtyre ligjeve, si dhe aktorët e tjerë të përfshirë në proces. Për shembull, nëse pushteti komunal e kundërshton zbatimin e ligjit, a kanë patur mundësi t’i parashtrojnë vërejtjet e veta para se ligjet të hynin në fuqi? Zërat e kujt janë dëgjuar gjatë debatit? Në ç’masë janë ndryshuar propozimet fillestare gjatë debatit publik dhe në kuvend? Cilat kanë qenë argumentet kryesore për miratimin e ligjeve? Kornizat dhe arsyetimi për pranimin e këtyre ligjeve mund të na ndihmojnë të shpjegojmë distancën midis detyrimeve ligjore për mbrojtjen e minoriteteve dhe implementimit të tyre.

<sup>205</sup> Kategoria e “komunitetit” ka të bëjë me pakicën serbe, turke, boshnjake, ashkali, rome, egjiptase dhe gorane. Përdorimi i tij është zgjedhur në Kosovë në vend të nocionit “pakicë etnike” për dy arsye: 1) nocioni “pakicë” mund të ketë konotacione negative për pakicat (veçanërisht serbët); 2) vetë terminologjia vë në pah barazinë midis shqiptarëve dhe popullsisë joshqiptare (Toth dhe Vizi, 2014).

Literatura në dispozicion nuk ofron përgjigje për këto çështje. Pjesa më e madhe e hulumtimeve ekzistuese përqendrohet te mekanizmat institucionalë të mbrojtjes së pakicave duke ofruar informacione të dobishme mbi legjislacionin e Kosovës (Beha, 2014) dhe efektet e ndarjes së pushtetit (Lončar, 2015). Mirëpo, ende dimë shumë pak mbi mënyrën e arsyetimit të këtyre ligjeve të rëndësishme për minoritetet dhe mbi shkaqet e zbatimit të tyre të ngadalshëm.

## **Metodat dhe të dhënat**

Për të kuptuar mënyrën e miratimit të ligjeve të rëndësishme për pakicat, sidomos të Ligjit për Prizrenin dhe Ligjit për Hoçën e Madhe, ky punim përqendrohet në praktikën legjislative, në vend që të vrojtojë produktin e fundit. Ekzistojnë dy arsye për interesimin tim për procesin e miratimit të ligjeve për Prizrenin dhe Hoçën e Madhe. E para, njohja e trashëgimisë kulturore të një grupi simbolizon njohjen e identitetit kulturor të atij grupi, si dhe të pranisë së tij historike në një territor të caktuar. Trashëgimia kulturore në Kosovë është e lidhur ngushtë me konfliktet midis serbëve dhe shqiptarëve rreth çështjes së të drejtës mbi territorin. Për shumë shqiptarë, trashëgimia kulturore serbe simbolizon vitet e represionit dhe diskriminimit, ndërsa për shumë serbë ajo paraqet simbolin e djepit të kombit serb (Arraiza, 2014). Prandaj, mund të pritet që debati për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore serbe të ketë përfshirë aktorë të ndryshëm, perceptime, emocione dhe paraqitje të ndryshme për grupin tjetër etnik. E dyta, meqenëse trashëgimia kulturore nuk është e rëndësishme ekskluzivisht për pjesëtarët e komuniteteve pakicë, në këtë fushë mund të formulohet më lehtë një strategji efektive për intensifikimin e dialogut dhe pajtimin ndëretnik. Në pjesën më të madhe të literaturës ekzistuese thuhet se në situatat postkonfliktuale trashëgimia kulturore bëhet shpesh një simbol i fuqishëm dhe instrument i pajtimit (Preis and Mustea, 2013). Meqenëse kultura zotëron potencialin si për lehtësuar kohezionin shoqëror, ashtu edhe për të justifikuar përjashtimin social, analiza e legjislacionit mbi trashëgiminë kulturore të pakicave mund të na ndriçojë marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë.

Punimi bazohet në analizën e 29 teksteve, të cilët përfshijnë sidomos dokumente zyrtare, në të cilat parashtrihen qëndrimet e përfaqësuesve politikë dhe të sektorit civil rreth drafteve të ligjeve. Lista e dokumenteve të analizuara është dhënë në shtojcën në fund të punimit. Të gjitha dokumentet e analizuara ishin në dispozicion në internet. Në këtë punim shfrytëzohet analiza kritike kornizuese (*critical frame analysis*) e dokumenteve të përzgjedhura me qëllim të të kuptuarit të procesit legjislativ dhe paraqitjes së çështjeve në rendin e ditës. Analiza kritike kornizuese paraqet një version të analizës kornizuese (*frame analysis*), e cila idesë së “pakos kornizuese” (*“frame package”*) i shton dimensionin e “zërit” (*“voice”*).

Korniza (*frame*), koncepti qendror i analizës kornizuese, përdoret tashmë gjerësisht në fusha të ndryshme, siç janë antropologjia (Bateson, 1972), sociologjia (Goffman, 1974), literatura për lëvizjet shoqërore (Benford and Snow, 2000, Snow and Benford,

1988) dhe analiza e medias (Gamson dhe Modigliani, 1989; Van Gorp, 2007). Pakoja kornizuese përbëhet nga korniza dhe mjetet për vendosjen në korniza dhe rezonim, e rëndom përkufizohet si ide ose tregim që ofron kuptimin mbi realitetin (Gamson, 2004; Gamson dhe Modigliani, 1989; Goffman, 1974) dhe që kryesisht nënkupton një varg qëndrimesh të ndryshme, të cilat ndërtojnë kuptimin nëpërmjet organizimit dhe lidhjes së simboleve të ndryshme, figurave dhe argumenteve (Gamson, 2004). Nga ana tjetër, mjetet për vendosjen në kuadër përfshijnë zgjedhjen e fjalëve, metaforat, përshtimet, ose mjete të tjera simbolike që sugjerojnë si të mendohet për një çështje politike të dhënë (Gamson dhe Modigliani, 1989, fq. 3), ndërsa mjetet e rezonimit kanë të bëjnë me “deklaratat eksplicite dhe implicite që merren me arsyetime, me shkaqet dhe pasojat në rendin kohor, të cilat plotësojnë pakon kornizuese” (Van Gorp, 2007, fq. 64). Ndërsa korniza na fton që propozimin e politikës ta lexojmë në një mënyrë të caktuar, zbatimi i saj nëpërmjet mjeteve të formimit dhe rezonimit të tij siguron të shprehurit specifik të problemit (diagnoza), shpjegimin se pse është e qenësishme zgjidhja e problemit dhe se në cilën mënyrë duhet të zgjidhet ai (prognoza) (Bacchi dhe Eveline, 2010, Meier, 2008, fq. 156; Verloo dhe Lombardo, 2007).

Analiza kritike kornizuese të gjithave që u përmendën më sipër u shton edhe dimensionin e “zërit”, i cili paraqet një shtesë “kritike” për “analizën kornizuese”. Dimensioi i “zërit” sugjeron kush e ka zërin në përcaktimin e problemit dhe në vendimmarrjen për mënyrën sesi duhet zgjidhur problemi. Siç e kanë shpjeguar Verloo dhe Lombardo (Verloo and Lombardo, 2007, 34), “ai e lehtëson analizën në sensin e përfshirjes/përrjashtimit dhe në kuptimin e fuqisë/pushtetit që e mundëson përcaktimin se cilët zëra (perspektiva dhe përvoja) janë të përfshirë më shpesh ose të përjashtuar nga mundësia për vendosjen e problemeve politike dhe zgjidhjeve në kornizë në dokumentet zyrtare.” Duke u mbështetur në këtë teori, kam propozuar një varg pyetjesh për nevojat e realizmit të analizës (shih ilustrimin 1). Pyetjet në ilustrimin 1. më kanë mundësuar të përcaktoj se kush e ka patur zërin në përcaktimin e problemeve dhe në ç’ mënyrë domethëniet, problemet dhe pozicionet janë ndërtuar gjatë debatit rreth ligjeve për Prizrenin dhe Hoçën e Madhe. Me ta vendosur problemin në kornizë, në mënyra të caktuara po ashtu bëhet përzgjedhja e asaj çka duhet konsideruar si problem dhe zhvendoset vëmendja nga çështjet e tjera.

Ilustrimi 1: Hapat në kornizën e analizës së procesit legjislativ	
1. Dimensioni kuadrues	
-	Cilat janë kornizat kryesore në formësimin e ndërtimit dhe interpretimit të problemit?
2. Dimensioni i problemit	
-	Çfarë perceptohet si problem?
-	Pse shihet si problem? Cilat presupozime qëndrojnë pas një përfytyrimi të caktuar rreth „problemit“? Cilat pasoja prodhon paraqitja e këtillë e problemit?
-	Çfarë ka mbetur joproblematike në vendosjen e problemit në kornizë? Çfarë është lënë në heshtje? Cilat çështje janë përjashtuar nga debati?
3. Dimensioni i zërit	
-	Cilët aktorë kanë zërin kryesor në ndërtimin dhe artikulumin e problemit?
-	Problemi është paraqitur si problem i kujt? Në emër të kujt veprohet?
-	Cilët aktorë janë përjashtuar nga debati?

## Gjetjet e përgjithshme

Ligjet për Prizrenin dhe Hoçën e Madhe i ka propozuar qeveria, ndërkohë që u përgatitën në bashkëpunim me Kancelarinë Civile Ndërkombëtare (KCN). Janë shqyrtuar bashkërisht në Kuvend dhe për shkak të ngjashmërisë midis tyre, ndaj tyre u paraqitën amendamente dhe vërejtje të ngjashme.

Miratimit të ligjeve në Kuvend i ka paraprirë një debat i gjatë dhe i ashpër. Organizatat e shoqërisë civile (OSHC) nga Prizreni e Rahoveci kanë organizuar protesta<sup>206</sup> kundër miratimit të tyre. Peticionet e OSHC-së të drejtuara Kuvendit, me të cilat kërkohej hedhja poshtë e ligjit, i nënshkruan më shumë se 10 000 njerëz. Darftligjet i kritikuan po ashtu edhe pushtetet lokale në Prizren e Rahovec, si dhe Kuvendi i Kosovës. Kuvendi komunal i Prizrenit organizoi një mbledhje për të debatuar për Ligjin për Prizrenin dhe lëshoi një deklaratë me kërkesën drejtuar Kuvendit të Kosovës që ta hedhë poshtë atë ligj. Komisioni Parlamentar<sup>207</sup> për Bujqësi, Pylltari, Mjedisin Jetësor dhe Planifikimin Hapësinor, të cilit iu dha roli i komisionit kryesor për rishikimin e ligjit, po ashtu me vendim unanim i rekomandoi Kuvendit që t’ia kthejë ligjet për rishikim qeverisë dhe ftoi për debat të gjerë publik në procesin e përgatitjes së drafteve të reja. Krahas kësaj, një grup prej 12 deputetësh kërkoi vlerësimin kushtetues të draft-ligjit nga Gjykata Kushtetuese. Ekzistonte një miratim i përgjithshëm prej pjesëmarrësve në debatet publike dhe parlamentare se projektligjet duheshin hedhur

<sup>206</sup> Protesta më masive u organizua në Prizren më 29 janar të vitit 2012. Me atë rast u tubuan disa mijëra njerëz, ndërsa ngjarjen e mbështeti Kuvendi Komunal i Prizrenit dhe partitë politike Vetëvendosje (VV), AKR dhe Partia Demokratike Turke e Kosovës.

<sup>207</sup> Në Kosovë për këshillat parlamentare përdoret fjala komision, prandaj edhe unë në këtë punim do të përdori të njëjtin term.

poshtë dhe duheshin shkruar nga e para. Ata ftuan për një proces transparent dhe inkluziv, i cili do të përfshinte ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë nga fusha e trashëgimisë kulturore, ekspertë juridikë dhe organizatat e shoqërisë civile. Përkundër kundërshtimit të fuqishëm, të dy ligjet u aprovuan me disa përmirësime të vogla në Kuvendin e Kosovës më 20 prill të vitit 2012. Shumica e votave për të dyja ligjet u siguroi nga pozita, si nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK)<sup>208</sup>, ashtu edhe nga deputetët e komuniteteve, me ndihmën e disa deputetëve të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Aleancës Kosova e Re (AKR)<sup>209</sup>.

Debati për dy ligjet mori formë rreth dy kornizave kryesore: kornizës së “kërcënimit” dhe “pavarësisë”. Kornizën e “kërcënimit” e pranuan dhe përdorën shumë anëtarë të Kuvendit të Kosovës në cilësinë e përfaqësuesve të partive të ndryshme në pushtet dhe në opozitë, të Kuvendit Komunal të Prizrenit dhe Rahovecit, si dhe OSHC nga Prizreni dhe Rahoveci, ndërsa pohimet e përfaqësuesve të qeverisë u paraqitën nëpërmjet kornizës së “pavarësisë”.

Protagonistët e pakos së kornizës së “kërcënimit” pohonin se problemi kryesor lidhur me propozim ligjet për Prizrenin dhe Hoçën e Madhe ishte përfshirja e Kishës Ortodokse në këshillat komunalë për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Gjatë debatit për ligjet u ofruan arsytetime dhe shpjegime nga më të ndryshmet të problemit, çka solli krijimin e nënpakos së kornizës: dikriminimi, pajtueshmëria me Kushtetutën, pronësia mbi trashëgiminë kulturore dhe konflikti ndëretnik. Nga ana tjetër, korniza e “pavarësisë” u ndërtua rreth problemit të refuzimit potencial të të dy projektligjeve dhe pasojave të tyre. Refuzimi i projektligjeve konsiderohej si pengesë për pavarësinë e plotë të Kosovës dhe respektit të bashkësisë ndërkombëtare.

## **Korniza e kërcënimit**

Korniza e kërcënimit u përpunua nëpërmjet paraqitjes së serbëve dhe Kishës Ortodokse. Kisha Ortodokse paraqitej si armike dhe bashkëpjesëmarrëse në gjenocid. Në këtë rast, miratimi i mbrojtjes së lokaliteteve të Kishës Ortodokse dhe dhënia e të drejtave të posaçme të administrimit mbi ato lokalitete vendoseshin në kuadrin e sulmeve mbi shtetësinë e Kosovës. U pohua se Kisha Ortodokse edhe më tej konsideron Kosovën “pjesë të patjetërsueshme të territorit të kombit, shtetit dhe kishës serbe” (Nait Hasani, PDK). Serbët më tej paraqiteshin si ata që nuk duan të integrohen dhe ta njohin shtetin e Kosovës (Deklaratë e Kuvendit Komunal të Rahovecit, 17. 6. 2011). Ligjet paraqiteshin si kërcënim për pavarësinë mezi të fituar, ndërsa refuzimi i ligjeve kuptohej si akt patriotizmi dhe krenarie. Për fuqizimin e narrativës mbi kërcënimin u përdorën korniza të tilla si “serbizimi i Kosovës”, “terrori”, “poshtërimi” dhe “komuna

<sup>208</sup> Të gjithë deputetët e PDK-së, të cilët e morën fjalën në komisionin parlamentar dhe në seancat plenare angazheshin për hedhjen poshtë të ligjit. Mirëpo, disiplina partiake mbizotëroi dhe qeveria ia doli të sigurojë shumicën e nevojshme. Para votimit, disa deputetë pohonin se deputetët e PDK-së kanë marrë udhëzime të detajuara si të votojnë për secilin amendament.

<sup>209</sup> Ligji për Hoçën e Madhe u miratua me 59 vota, nërsa Ligji për Prizrenin me 56 vota. Kuvendi i Kosovës ka 120 deputetë.

në komunë”. Për shembull, Alma Lama (Lidhja Demokratike e Kosovës, LDK) pohonte se miratimi i ligjeve do të thotë “serbizim i Kosovës” (Seanca plenare, 20.04.2012). Krahas kësaj, anëtarët e Kuvendit Komunal të Komunës së Rahovecit deklaruan: “Ne, anëtarët e Komisionit për Politikë dhe Financa e shohim miratimin e ligjit si të paarsyeshëm, sepse me të parashihet formimi i një mini-komune në komunën e Rahovecit, të cilës i përket fshati Hoçë e Madhe, i banuar nga minoriteti serb”.

Perceptimi i serbëve dhe Kishës Ortodokse si kërcënim kryesor për shtetësinë e Kosovës solli si pasojë kundërshtimin e fuqishëm të projektligjeve. Shkas për këtë kornizë “kërcënim” është përfshirja e propozuar e përfaqësuesve të Kishës Ortodokse në Këshillin për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit dhe Hoçës së Madhe. Sipas nenit 4.3 të Projektligjit për Hoçën e Madhe, Këshilli i fshatit të Hoçës së Madhe përbëhet nga pesë anëtarë: dy anëtarë që i zgjedh Kuvendi Komunal i Rahovecit, dy anëtarë të zgjedhur nga banorët e Hoçës së Madhe dhe një anëtar që e emëron Kisha Ortodokse Serbe. Sipas ligjit, Këshilli ka të drejta konsultative rreth çështjeve lidhur me mbrojtjen dhe përparimin e trashëgimisë fetare dhe kulturore në fushën e planifikimit rural. Në vend të numrit të përbërjes të paraqitur më sipër, anëtarët e këshillit të Kuvendit Komunal propozuan që Këshilli të rrisë numrin e përfaqësuesve në shtatë anëtarë: katër të zgjedhur nga Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe tre të zgjedhur nga banorët e Hoçës së Madhe, çka e përjashtonte Kishën Ortodokse Serbe nga pjesëmarrja në punën e Këshillit.

Në mënyrë të ngjashme, Projektligji për Prizrenin (neni 16) parashikonte formimin e Këshillit për Trashëgiminë Kulturore të Prizrenit me të njëjtat kompetenca si Këshilli për Trashëgiminë e Hoçës së Madhe edhe me përfshirjen e përfaqësuesve fetarë. Siç u propozua fillimisht, e përfundimisht edhe u miratua, Këshilli për Trashëgiminë e Prizrenit përbëhet nga shtatë anëtarë: një përfaqësues nga Kancelaria Komunale e Prizrenit, e ndarkuar me çështjet e komuniteteve dhe kthimit, si dhe gjashtë anëtarë nga sektori civil kosovar me përvojë në ruajtjen, zhvillimin dhe/ose promovimin e trashëgimisë kulturore të Prizrenit. Midis gjashtë anëtarëve të shoqërisë civile, një anëtar duhet ta zgjedhë komuniteti islam, një anëtar duhet ta zgjedhë Kisha Ortodokse Serbe, ndërsa një anëtar Kisha Katolike. Të paktën dy anëtarë nga sektori civil duhet të jenë ekspertë të njohur në fushën e trashëgimisë kulturore. Kundërpropozimi i komisionit parlamentar parashikonte që Këshilli i Prizrenit të kishte gjashtë anëtarë dhe vetëm përfaqësues të shoqërisë civile me përvojë në ruajtjen, zhvillimin dhe/ose promovimin e trashëgimisë kulturore të Prizrenit, pa përfshirjen e përfaqësuesve fetarë.

Përfshirja e përfaqësuesve të Kishës Ortodokse në këshillat për trashëgiminë kulturore të Prizrenit dhe Hoçës së Madhe u vendos në kornizën diskriminuese, jokushtetuese dhe të prishjes së karakterit shekullar të Kosovës. Si të tillë, propozimin e kundërshtuan ashpër komisioni parlamentar i ngarkuar me vlerësimin e projektligjeve, një grup organizatash të shoqërisë civile dhe kuvendet komunale.



Kundërshtarët e ligjit si një problem tjetër të madh shihnin edhe nenin 18.4 të

Projektligjit për Prizrenin, sipas të cilit: Komisioni kërkon pëlqimin e Kishës

Ortodokse Sebe për çfarëdo aktivitetesh që do të ndikonin në pronën e Kishës Ortodokse Serbe në qendrën historike të Prizrenit, në harmoni me Aneksin V të Propozimit Gjithpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës dhe Kushtetutën.

Ky nen shkaktoi emocione të fuqishme. Deputeti Emin Gërbeshi (Vetëvendosje), për shembull, pohonte se “Ligji është antishqiptar, antihistorik dhe jonjerëzor. Madje na kthen në mesjetë kur kisha i rregullonte të gjitha” (Seanca plenare, 20. 04. 2012). Anëtarët e Kuvendit Komunal të Prizrenit po ashtu i drejtuan vërejtjet e tyre ndaj faktit se të gjitha punimet ndërtimore rreth objekteve ortodokse varen nga Kisha Ortodokse. Është pohuar se Kishës Ortodokse në Kosovë po i jepen më shumë kompetenca sesa në Serbi.

Pjesët në vijim të punimit do të fokusohen më detajisht në argumentet dhe arsyetimet për perceptimin e përfshirjes së përfaqësuesve të Kishës Ortodokse si problematike.

### **Diskriminimi dhe barazia**

Në të gjitha dokumentet e analizuara, diskriminimi ishte argumenti më i dukshëm kundër përfshirjes së përfaqësuesve ortodoksë serbë në Këshillat për Trashëgiminë. Korniza e diskriminimit, e cila u shfaq së pari në diskursin e OJQ-ve lokale dhe përfaqësuesve të komunave të Prizrenit dhe Rahovecit, mbizotëroi gjithashtu në debatet parlamentare. Gjatë debateve, u formuan tri qëndrime për diskriminimin: 1) përfshirja e përfaqësuesve fetarë serbë paraqet diskriminim të qytetarëve të Kosovës; 2) përfshirja e përfaqësuesve fetarë serbë paraqet diskriminim të komuniteteve fetare të tjera; 3) përfshirja nuk mund të trajtohet si diskriminim nëse askush nuk është përfshiruar.

Së pari, Kisha Ortodokse paraqet si e vetmja shfrytëzuese e ligjit, gjë që vetvetiu paraqet diskriminim të qytetarëve të tjerë të Prizrenit dhe Rahovecit. Për shembull, deputeti Liburn Aliu (Vetëvendosje) pohonte se banorët e Hoçës së Madhe nuk janë vetëm serbë, por edhe ateistë dhe pjesëtarë të komunitetit islam dhe katolik. Duke e mbrojtur vetëm trashëgiminë kulturore ortodokse, të gjithë banorët e tjerë të Hoçës së Madhe janë të diskriminuar. Së dyti, u shprehën opinione se Kisha Ortodokse Serbe është e favorizuar në raport me komunitetet tjera fetare. Në komunikatën e 26 gushtit të vitit 2011, Koalicioni i OJQ-ve në mbrojtje të Qendrës Historike të Prizrenit deklaroi se “përmbajtja e ligjit i mundëson një zë shtesë Kishës Ortodokse”. Diskriminimin pozitiv të Kishës Ortodokse në raport me komunitetet tjera fetare e kanë theksuar po ashtu Bashkësia Islame, anëtarë të tjerë të komisionit parlamentar

dhe Kuvendi Komunal. Edhe pse në projektligj saktësohej se krahas Kishës Ortodokse, edhe Kisha Katolike dhe Bashkësia Islame zgjedhin nga një anëtar të Këshillit për Trashëgiminë Kulturorë në Prizren, argumentet mbi diskriminimin u përqendruan vetëm te përfshirja e komunitetit ortodoks serb.

Paraqitja e serbëve si grup etnik i privilegjuar nuk pasqyrohet vetëm te imazhi i serbëve, por edhe te vetëperceptimi i shqiptarëve si komunitet shumicë. Dhënia e të drejtave shtesë për serbët i vë të gjithë të tjerët në një pozitë të nënshtuar. Një shembull të kësaj e gjejmë në deklaratën e Qemajl Kurtishit, përfaqësues në Kuvendin Komunal të Prizrenit, i cili pohonte se Ligji për Prizrenin paraqet një sulm mbi identitetin e tij dhe e fyen atë si “mysliman kosovar” (08.09.2011).

Edhe pse shumica e aktorëve të drejtat shtesë të Kishës Ortodokse i vendoste në kornizën e diskriminimit dhe kërcënimit për trajtimin e barabartë dhe identitetin e qytetarëve të Kosovës, me Kushtetutë Kosova përkufizohet si shoqëri multietnike dhe me të garantohen të drejta të veçanta për ata që janë në pozitë të pabarabartë. Duke u mbështetur mbi këtë fakt, Gjykata Kushtetuese në vlerësimin e saj mbi kushtetutshmërinë e Ligjit për Prizrenin dhe Hoçën e Madhe u angazhua për qëndrimin e tretë mbi diskriminimin të paraqitur më sipër:

Duke ua dhënë të drejtën për të marrë pjesë në procesin e planifikimit lokal, dy ligjet në shqyrtim mundësojnë pjesëmarrjen e Kishës Ortodokse Serbe, Bashkësisë Islame dhe Kishës Katolike, me çka askush nuk është përjashtuar nga pjesëmarrja në proces. Ajo çka bëjnë dispozitat e ligjeve të kontestuar është formalizimi i pjesëmarrjes dhe konsultimeve me trupat e përmendur. Ata e bëjnë këtë në pajtim me gërmën dhe frymën e Kushtetutës dhe në pajtim me pozitën e veçantë të komuniteteve në Republikën e Kosovës dhe karakterin multietnik të shtetit.

Mirëpo, vendimi i Gjykatës Kushtetuese u mor në qershor të vitit 2012, tre muaj pas miratimit të ligjeve në Kuvend. Meqenëse askush nga aktorët e tjerë të përfshirë në debat nuk e përmendi të kuptuarin multikulturor të barazisë, procesi legjislativ dhe debatet publike në masën më të madhe u vendosën në kornizën e kërcënimit. Mungesa e kundërgjyqësive i forcoi edhe më shumë perceptimet se ligjet janë të padrejta dhe se Kisha Ortodokse është e privilegjuar në raport me të tjerët.

### **Pajtuësshmëria me Kushtetutën – shekullariteti dhe neutraliteti në çështjet fetare**

Argumenti tjetër më i fuqishëm kundër përfshirjes së përfaqësuesve të komunitetit fetar serb ka të bëjë me kushtetutshmërinë dhe sekularizmin. Dy ligjet në shqyrtim nuk u cilësuan vetëm si diskriminues, por edhe si jokushtetues dhe në kundërshtim me sekularizmin dhe neutralitetin shtetëror rreth çështjeve fetare. Përveç deklaratës së organizatave serbe të shoqërisë civile dhe aktvendimit të Gjykatës Kushtetuese, në të gjitha dokumentet e tjera të analizuar është e theksuar paraqitja e ligjeve si jokushtetuese. Më i zëshmi në shtrimin e çështjes së sekularizmit dhe kushtetutshmërisë ishte deputeti i popullit Nait Hasani (PDK), i cili pohonte si vijon:

“Me kërkesën që komunitetet fetare të përfshihen në ligj, me këtë ligj është shkelur neni 8 i Kushtetutës. Këtu do të duhej të miratohej vendimi nëse ne jemi shtet fetar ose shekullar” (Seanca plenare, 20.04.2012).

Gjykata Kushtetuese dhe aktorët ndërkombëtarë morën qëndrime të ndryshme brenda së njëjtës kornizë. Gjykata Kushtetuese deklaroi se nuk është shkelur parimi i sekularizmit meqenëse “ua mundëson organizatave fetare t’i kryejnë punët e tyre pa përzierjen e paarsyeshme të shtetit, ndërsa organizatat fetare nuk mund të përcaktojnë se çka shteti mund ose nuk mund të sanksionojë me ligj”. Mirëpo, gjatë debatit publik dhe parlamentar, i vetmi aktor që mori një qëndrim të ngjashëm që Peter Feith, shef i Kancelarisë Civile Ndërkombëtare, i cili pohonte se Franca është po ashtu shtet shekullar, por, pavarësisht nga kjo, u jep të drejta të caktuara komuniteteve fetare. Ai ka thënë po ashtu se qëllim kryesor i këtyre ligjeve është dhënia e të drejtave fetare për komunitetet. Prandaj, përjashtimi i përfaqësuesve të kishës nga procesi i marrjes së vendimeve do të paraqiste shkelje të qëllimit themelor të këtyre ligjeve (Mbledhja e Komisionit, 26.03.2012). Qeveria, e cila i propozoi projektligjet, mbante një qëndrim mjaft defensiv, duke theksuar se Kishës Ortodokse nuk i është dhënë pushtet ekzekutiv, por vetëm një rol konsultativ lidhur me ato çështje që kanë të bëjnë me fshatin Hoçë e Madhe dhe Qendrën Historike e Prizrenit.

### **Kush e zotëron kulturën?**

Pohimet për pronësinë mbi kulturën ishin jashtëzakonisht të pranishme gjatë debateve në komisione, të cilat edhe më tej fuqizuan perceptimin e kërcënimit. A u përkasin objektet dhe lokacionet ortodokse serbëve apo të gjithë qytetarëve të Kosovës? Kujt i përket vetë Kisha Ortodokse? Gjatë debatit lidhur me këto çështje, perceptimi kryesor ishte se ligjet ua marrin qytetarëve të Kosovës trashëgiminë kulturore dhe serbëve u japin pronësinë ekskluzive mbi trashëgiminë kulturore. Duke iu referuar qëndrimit se trashëgimia ortodokse i përket Kosovës, e jo vetëm serbëve, deputetët e popullit Liburn Aliu (VV), Nijazi Idrizi (PDK) dhe ca të tjerë, propozuan që në ligje të mos përdoren shprehjet si “Kisha Ortodokse Serbe”, por “Kisha Ortodokse në Kosovë”. Ata po ashtu shtruan edhe çështjen e origjinës së kishave dhe manastireve ortodokse, duke këmbëngulur se kishat ortodokse ishin ndërtuar mbi themelet e kishave iliro-shqiptare (Nue Oroshi, Kuvendi i Prizrenit). Pohime të tilla e fuqizuan edhe më shumë perceptimin negativ të serbëve si të të “Tjerëve” që paraqesin kërcënim për ndërtimin e shtetit dhe kombit kosovar. Të njëjtit qëllim i shërbente edhe pohimi se trashëgimia fetare si e tillë në të vërtetë nuk ekziston. Këshilli i Kosovës për trashëgiminë kulturore pohonte se UNESCO nuk e ka pranuar shprehjen “trashëgimi fetare”, prandaj vetvetiu e gjithë trashëgimia është “kulturore”, e jo “fetare”.

Krahas kësaj, pritej që dhënia e të drejtave rregullatore (e me këtë edhe i të drejtës në pronësi) Kishës Ortodokse do ta asgjësonte trashëgiminë e Kosovës. Edhe pse nuk kishte shpjegime se për ç’arsye pjesëmarrja e përfaqësuesve të Kishës Ortodokse në këshillin për trashëgiminë kulturore të Prizrenit dhe Hoçës së Madhe do ta asgjësonte trashëgiminë, komisioni parlamentar e përsëriste shpesh këtë pohim.

## **Konflikti ndëretnik dhe fetar**

Një argument shtesë kundër dy ligjeve në shqyrtim, e veçanërisht kundër përbërjes së propozuar të këshillave për trashëgiminë, kishte të bënte me faktin se dhënia e kompetencave publike komuniteteve fetare nxiti urrejtjen dhe konfliktin fetar. Anëtarët e Kuvendit Komunal të Rahovecit kanë deklaruar se Ligji për Hoçën e Madhe është “i dëmshëm jo vetëm për komunën e Rahovecit, por edhe për vetë pjesëtarët e pakicës serbe, meqenëse fut ndasinë etnike në komunën tonë dhe do të pasqyrohet negativisht në rritjen e tensioneve midis shumicës shqiptare dhe pakicës serbe” (17.06.2011).

Konfliktin e përmendnin po ashtu edhe OJQ-të serbe, por duke e shpjeguar në një mënyrë paksa të ndryshme. Në ftesën e vet drejtuar shoqërisë civile dhe qytetarëve të Prizrenit për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, Rrjeti Kosovar Strategjik-Aksional (KSAM) shkaqet e konfliktit ndëretnik i gjen te protestat që organizonte sektori civil. KSAM pohon si vijon:

“Kemi frikë se kjo protestë është ftesë për grupet ekstreme për mostolerancë fetare, mosrespektim të kulturave të tjera dhe diversitetit, që rregullisht kulminon dhe shndërrohet në dhunë... Konsiderojmë se një sjellje e këtillë e shoqërisë civile në Kosovë është për keqardhje, meqenëse ata që do të duhej të ishin bartës të ndryshimeve pozitive dhe pajtimit midis komunitetesh, gjithnjë e më shpesh me protestat e veta, me retorikën jo të përshtatshme dhe gjuhën e urrejtjes, i kontribuojnë rritjes së tensioneve.”

## **Korniza e pavarësisë**

Edhe pse korniza e kërcënimit ishte dominante gjatë debatit, kishte përpjekje individuale që ligjet të paraqiten në një mënyrë më pozitive. Përpjekjet në fjalë u shprehën nëpërmjet kornizës së pavarësisë. Kryeministri Hashim Thaçi dhe ministri Dardan Gashi ishin më të zëshmit rreth kësaj çështjeje. Për ta, gjatë debatit për ligjet, problemi më i madh ishte refuzimi i projektligjeve. Meqenëse Plani i Ahtisarit kërkonte miratimin e këtyre ligjeve, refuzimi i tyre do ta pengonte njohjen e Kosovës si plotësisht të pavarur dhe do të pasqyrohej negativisht në pozitën e saj ndërkombëtare. Miratimi i këtyre dy ligjeve paraqiste një ndër kushtet e fundit për përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrrur të Kosovës. Ky argument përsëritej në çdo rast dhe ofrohej si përgjigje ndaj pjesës më të madhe të vërejtjeve kundër këtyre ligjeve. Kryeministri Hashim Thaçi ishte veçanërisht i zëshëm në paraqitjen e ligjeve si beteja e fundit për pavarësinë:

“Jam i bindur se të gjithë ju e doni Kosovën dhe dëshironi që vendi ynë të jetë një shtet serioz, të përparojë dhe mbi të gjitha, t’i plotësojë obligimet e veta në trajtën e detyrimeve të marra ndaj bashkësisë ndërkombëtare. Jeni të vetëdijshëm se gjatë këtij viti së bashku kemi filluar me miratimin e ligjeve të fundit nga Pakoja e Ahtisarit. Për ta përfunduar këtë proces, për ta siguruar përfundimin e fazës së

mbikëqyrjes së pavarësisë nga bashkësia ndërkombëtare, e veçanërisht nga Kancelaria Civile Ndërkombëtare. Këtë çështje do të duhej kuptuar shumë seriozisht, meqenëse ajo paraqet edhe një moment historik për Kosovën. Ky është momenti kur Kosova para botës demokratike dëshmon se jemi të konsoliduar si shtet, si institucione dhe si qytetarë dhe e vazhdojmë rrugën tonë plotësisht të pavarur. Kjo ngjarje kyçe dëshmon se shoqëria jonë nuk do të kthehet në të kaluarën e hidhur dhe jo aq të largët. (Seanca plenare, 20. 04. 2012).

Duke komentuar Ligjin për Prizrenin, Dardan Gashi, ministër në Qeverinë e Kosovës, deklaroi: “Ky ligj ndikon drejtpërdrejt në marrëdhëniet e Republikës së Kosovës me miqtë dhe aleatët e saj dhe meqë është i tillë, unë ju lus dhe apeloj që ligji të miratohet në formën e propozuar” (Seanca plenare, 20.04.2012).

Duke u pëgjigjur ndaj deklaratave të cituara më sipër, disa deputetë dhe anëtarë të kuvendeve të Prizrenit dhe Rahovecit mbronin qëndrimin se Parlamenti nuk duhet të shantazhojë për t’i miratuar ato ligje të imponuara. Hydajet Hyseni (PDK) pohonte se në “Serbi shteti është po ashtu shekullar. Në Serbi, kisha është e ndarë nga shteti dhe komunitetet fetare në Serbi kanë trajtim të barabartë. Për ç’arsye Kosova do të duhej të shkonte më larg se kjo? Për ta kënaqur dikë dhe për t’u maskuar?” (Seanca plenare, 20. 04. 2012). Në vend të nënshtrimit ndaj kushteve të BE-së dhe KCN-së, disa deputetë të parlamentit pohonin se Kosova duhet të mbrojë pavarësinë dhe identitetin e vet. Për shembull, deputeti Nait Hasani (PDK) pohonte se “kjo nuk është çështje e Raportit [EU] për Progresin, por çështje e përkatësisë etnike, kulturore dhe problemeve të traditës” (Seanca plenare, 23. 08. 2011). Miratimi i këtyre ligjeve Kosovën e sjell para kapitullimit para Serbisë dhe bashkësisë ndërkombëtare, në vend se ta çojë drejt pavarësisë.

### **Përfshirja/përjashtimi i zërave: interpretimi i heshtjes**

Analiza ka treguar se kornizat më të spikatura janë ato të kërcënimit dhe pavarësisë. Plani i Ahtisarit i parashikonte këto dy ligje me qëllimin e mbrojtjes së trashëgimisë ortodokse të rrezikuar dhe forcimit të multikulturalizmit në Kosovë. Mirëpo, në opinionin publik kosovar këto ligje janë perceptuar si kërcënim i procesit të ndërtimit të shtetit dhe kombit në Kosovë. Meqenëse janë të tilla, debatet i fuqizonin edhe më shumë përfytyrimet tanimë ekzistuese negative për komunitetin serb dhe Kishën Ortodokse. Këto perceptimet ndikuan jo vetëm në ato që do të pohoheshin në debat, por edhe se cilët aktorë dhe çështje do të përjashtohen dhe përsheshten gjatë procesit legjislativ. Meqenëse këto çështje në masë të madhe dëshmojnë për natyrën komplekse të marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë, në vazhdim ato do të shqyrtohen më detajisht.

Është vërtetuar se ekzistojnë tri rrafshë përjashtimi: i pari, në nivel të çështjeve të ngritura gjatë debatit; i dyti, në nivel aktorësh në emër të të cilëve është folur ose të cilët janë perceptuar si ata mbi të cilët ndikon legjislati; dhe i treti, në nivel aktorësh që janë përfshirë në debat dhe i kanë përgatitur propozimet.

Pikësëpari, ka qenë e pritshme që korniza e multikulturalizmit do të theksohej në masë më të madhe gjatë debatit për mbrojtjen e trashëgimisë ortodokse fetare e kulturore. Debatu kryesisht ishte i orientuar te pjesëmarrja e serbëve në marrjen e vendimeve, ndërsa, për shembull, askush nuk i përmendte shkeljet e të drejtave të pakicave ose mundësinë për pajtim dhe fuqizim të dialogut ndëretnik. Ndërsa shumë përfaqësues politikë dhe të organizatave të sektorit civil konsideronin se trashëgimia kulturore nuk është e rëndësishme ekskluzivisht për pjesëtarët e një komuniteti, ky fakt nuk përdorej me qëllim të bashkimit të sërishëm të komuniteteve të ndara dhe përmirësimit të dialogut ndëretnik dhe pajtimit. Vetëm Peter Feith në disa raste vuri theksin tek të drejtat fetare dhe karakterin multi-etnik të Kosovës.

E dyta, pjesëmarrësit në debat pohonin se flasin ose në interes të qytetarëve të Kosovës, qytetarëve të Prizrenit dhe Rahovecit, ose të kulturës kosovare. Edhe pse ligjet ishin të një rëndësie të veçantë për pakicën serbe në Kosovë, komuniteti serb ose pakicat përgjithësisht nuk u perceptuan si trup elektoral mbi të cilin ndikojnë këto dy ligje. Në rastet e rralla kur debatuesit i përmendnin serbët, i paraqisnin këta të fundit më shpesh si armiq ose fajtorë sesa si një pakicë, trashëgimia kulturore e të cilës e ka të domosdoshme mbrojtjen. Për shembull, anëtarët e Kuvendit Komunal të Rahovecit u shprehën se Ligji për Hoçën e Madhe është i “dëmshëm pikësëpari për pakicën serbe, për arsye se ajo do të izolohet duke menduar se po e mbron fenë dhe kulturën e vet” (17. 06. 2011). Në një pohim të tillë vërehet se refuzimi i ligjeve që e mbrojnë trashëgiminë kulturore serbe mbrohet me argumentin se një gjë e tillë “është për të mirën e vetë atyre”.

Në fund, gjatë gjithë procesit po ashtu mungonte dialogu ndëretnik. Edhe pse aktorë të shumë morën pjesë në debat, më të zëshmit qenë kundërshtarët e ligjeve. Midis tyre kishte përfaqësues të shoqërisë civile dhe të partive politike të ndryshme, si nga koalicioni në pushtet (PDK, LDK, AKR), ashtu edhe nga opozita (Vetëvendosje, AAK). Mirëpo, përfaqësuesit e minoriteteve, nga të cilët mund të pritej se do t'i mbështesnin ligjet, nuk u angazhuan plotësisht në debatet legjislative.

U mbajt vetëm një mbledhje e përbashkët midis Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Panifikim Hapësinor dhe Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthimin. Mbledhja u organizua për arsye procedurale. Si komision i përhershëm, Komisioni për Pakicat ka të drejtë të vlerësojë legjislacionin që ka të bëjë me minoritetet, të debatojë rreth amendamenteve të miratuara në komisionet funksionale, kur ato kanë të bëjnë me pakicat, si dhe të japë rekomandime të bazuara në të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Komisioni për Pakicat i refuzoi të gjitha amendamentet, të cilat i kishte miratuar Komisioni për Planifikim Hapësinor, prandaj për këtë arsye u caktua mbledhja e përbashkët në përpjekje për të arritur një kompromis.

Krahas kësaj, përfaqësuesit e pakicave ishin gati të pavërejtshëm gjatë procesit legjislativ, edhe pse të dy ligjet kishin të bënin drejtdrejt me komunitetet pakicë, e veçanërisht me komunitetin serb. Madje edhe në rastet e rralla kur do ta merrnin fjalën, do të merrnin një pozicion mbrojtës duke iu referuar Planit të Ahtisarit dhe punës së KCN-së. Në mënyrë të ngjashme edhe organizatat serbe të shoqërisë civile

mbetën të heshtura. Përkundër organizatave shqiptare tepër aktive të shoqërisë civile, organizatat respektive serbe kanë lëshuar vetëm një komunikatë për media gjatë debatit parlamentar, i cili zgjati gati një vit. Në deklaratën e tyre ato iu drejtuan organizatave shqiptare të shoqërisë civile:

“Kolegët nga shoqëria civile që kanë protestuar në Prizren i ftojme që ta ndryshojnë qëndrimin, sepse shkatërrimi i trashëgimisë kulturore të kujtdo qoftë, e cila është e një vlere të jashtëzakonshme historike dhe artistike, mund ta përjetojë vetëm dënimin e gjeneratave të ardhshme.”

Mosdeklarimi i përfaqësuesve politikë dhe civilë të pakicave mund të shpjegohet me dëshirën e tyre për të mos i thelluar mospajtimet dhe të nxisin ashtu kundërshtime edhe më të ashpra. Konfirmimin e një shpjegimi të këtillë e gjej në deklaratën e deputetit serb Petar Miletiq (Partia e Pavarur Liberale – SLS), i cili tha se ka patur shumë vërejtje, por nuk ka dashur të nxisë mospajtime (Komisioni për Pakicat, 24.1.2012). Meqenëse me miratimin e ligjeve u desh të përfundonte pavarësia e mbikëqyruar, ndërsa bashkësia ndërkombëtare e mbështeste fort miratimin e tyre, mund të pritej se ato do të miratoheshin pavarësisht nga ndërhyrjet e përfaqësuesve të pakicave. Krahas kësaj, aktivitetet e përfaqësuesve të pakicave në mbrojtje të ligjeve kanë mundur ta polarizojnë debatin, i cili rëndom nuk u kontribuon zgjidhjeve kompromise (cf. Cianetti, 2014).

## **Diskutimi dhe përfundimi**

Analiza paraprake tregon se ligjet për qendrën historike të Prizrenit dhe fshatin Hoçë e Madhe në procesin legjislativ janë vendosur në kornizën e kërcënimit dhe të pavarësisë, po të dy këto korniza bazohen në paraqitjen negative të serbëve dhe Kishës Ortodokse. Serbët janë kuptuar si një grup enik tepër i privilegjuar, i cili paraqet rrezik për pavarësinë dhe shtetësinë e Kosovës dhe i cili refuzon të integrohet në shoqëri, ndërsa Kisha Ortodokse është paraqitur si armike dhe bashkëpunëtore në gjenocid. Paraqitjet e serbëve si grup etnik i privilegjuar janë pasqyruar edhe në vetëperceptimin e shqiptarëve si grup shumicë. Shqiptarët janë kuptuar implicite si viktima dhe mbrojtës të Kushtetutës dhe pavarësisë së Kosovës.

Për të siguruar refuzimin e ligjit, aktorët e përfshirë në gjithë procesin shfrytëzonin korniza si: diskriminimi, shekullariteti, kultura kosovare dhe kërcënimi nga konflikti ndëretnik. Mbrojtja e trashëgimisë kulturore serbe ishte e vendosur në kornizën e diskriminimit kundër qytetarëve të tjerë të Kosovës dhe trashëgimisë joortodokse. Propozimi që përfaqësuesit e kishës të marrin pjesë në këshillin lokal për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore paraqitej si jokushtetues deri në masën sa që do ta shndërronte Kosovën në shtet fetar. Krahas kësaj, duke e miratuar mbrojtjen e lokacioneve fetare ortodoke, pohohej se ligjet i privonin qytetarët e Kosovës nga trashëgimia e tyre kulturore. Në fund, u parashtrua edhe pohimi se refuzimi i ligjeve është i një rëndësie të veçantë për serbët, meqenëse me to do të shtohet jotoleranca dhe urrejtja ndaj komunitetit serb.

Ndërkohë që argumentet e cekura i përdornin në pohimet e tyre deputetët e popullit, anëtarët e kuvendeve lokale të Prizrenit dhe Rahovecit dhe përfaqësuesit e sektorit civil, qeveria dhe aktorët ndërkombëtarë e mbështesnin miratimin e ligjeve. Qeveria e kishte adoptuar kornizën e pavarësisë, duke i vendosur ligjet në kornizat e “interesit shtetëror”, “përparimit”, “obligimeve ndërkombëtare” dhe “momentit historik”. U parashtrua edhe pohimi se miratimi i këtyre ligjeve është kushti i fundit për realizimin e pavarësisë së plotë të Kosovës. Përfaqësuesit e qeverisë po ashtu u përpoqën që ta zvogëlojnë kundërshtimin ndaj ligjeve duke pohuar se Kishës Ortodokse i ishin dhënë vetëm të drejta konsultative. Prandaj, edhe pse u përpoq që ta zvogëlojë perceptimin e kërcënimit, qeveria gjithsesi i përmbahej narrativit sipas parimit “ne kundër tyre”, duke kontribuar kështu në mënyrë më delikate në krijimin e distancës dhe jotolerancës ndëretnike.

Edhe pse vetëm disa aktorë e mbështesnin miratimin e ligjeve, vetëm aktorët ndërkombëtarë u përpoqën të krijojnë imazhe pozitive për to. Ata theksonin karakterin multietnik të Kosovës dhe nevojën për mbrojtjen e pakicave. Përkundër pritjeve se përfaqësuesit e pakicave do të parashtronin mendimet e tyre lidhur me ligjet, zërat e pakicave nuk u dëgjuan gjatë debatit. Në fund, çështjet siç janë diskriminimi kundër pakicave, shkelja e të drejtave të pakicave, pajtimi dhe dialogu ndëretnik, po ashtu qenë përjashtuar nga debati.

Të gjitha këto pohime, si ato të përfshira, ashtu edhe ato të përjashtuara, dëshmojnë për marrëdhëniet komplekse ndëretnike në Kosovë. Pohimet e përfaqësuesve politikë e civilë kanë ndikim të fuqishëm në perceptimin e opinionit publik dhe marrëdhëniet ndëretnike. Me ndërtimin e perceptimeve negative të Tjetrit, debati për dy ligjet që kanë të bëjnë me pakicat i shërbeu mirëmbajtjes së sistemit të pabarazisë së grupeve dhe krijimit të diskriminimit.

Edhe pse ligjet më në fund u miratuan, kjo erdhi për shkak të trysnisë ndërkombëtare dhe kushtëzimit për realizimin e pavarësisë së plotë. Mirëpo, pa marrë parasysh që aktorët ndërkombëtarë e kishin një rol vendimtar në zanafillën dhe miratimin e këtyre ligjeve, ata megjithatë nuk arritën ta ndryshojnë mendimin e qytetarëve të Kosovës dhe qëndrimet ndaj pakicave. Një përfundim të këtillë e konfirmojnë vërtetimet paraprake mbi ndikimin e kufizuar të presioneve ndërkombëtare në politikat minoritare (Agarin, 2010; Canetti, 2014; Sasse, 2008; Schulze, 2010).

Shkurt, ky punim vë në pah se madje edhe legjislacioni i volitshëm për pakicat mund të shërbejë si mekanizëm përjashtimi. Edhe pse korniza legjislative në Kosovë e garanton mbrojtjen e plotë të të drejtave të pakicave, institucionet politike në Kosovë i nxisin dasitë etnike dhe tensionet ndëretnike. Prandaj, ky punim sugjeron se analiza e procesit të vendimmarrjes është një qasje më e mirë për t'i kuptuar marrëdhëniet ndëretnike në relacion me analizën e rezultateve të tyre.

## **Falenderim**

Falenderoj Hrvoje Paić, Florian Bieber dhe Aleksandar Pavlović për komentet ndihmëse mbi versionet më të hershme të këtij punimi, si dhe Adriana Zaharijević dhe Ana Sivački për përkthimin e tekstit nga anglishtja në serbisht.



## Shtojcë

Lista e teksteve të analizuara:

1. Kuvendi të Republikës së Kosovës. Transkriptet e seancave plenare, 23.8.2011 dhe 20.04.2012.
2. Komisioni Parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Mjedisin Jetësor dhe Planifikimin Hapësinor. Transkriptet e seancave plenare: 22.08.2011, 12.09.2011, 05.01.2012, 10.01.2012, 12.01.2012, 13.01.2012, 16.01.2012, 17.01.2012, 03.02.2012, 14.02.2012, 21.03.2012, 22.03.2012, 26.03.2012.
3. Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthimin, Transkriptet e seancave plenare: 24.01.2012, 24.02.2012, 28.02.2012, 17.04.2012.
4. Constitutional Court. Judgment in Cases KO45/12 and KO46/12, Request of Liburn Aliu and 11 other Members of the Assembly of the Republic of Kosovo for constitutional assessment of the Law on the Village of Hoçë e Madhe / Velika Hoça and the Law on the Historic Centre of Prizren.
5. Kuvendi i Komunës së Prizrenit. Procesverbal nga mbledhja XV, 8.9.2011.
6. Kuvendi i Komunës së Prizrenit. Deklaratë, 8.9.2011.
7. Komiteti për Politikë dhe Financa i Kuvendit të Komunës së Rahovecit. Deklaratë, 17.06.2011
8. OJQ EC Ma Ndryshe. Letër e hapur në lidhje me procesin e hartimit dhe miratimit të projektligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, për Kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Z. Jakup Krasniqin, 21.10.2011.
9. Koalicioni i OJQ-ve. Letër për Znj. Atifete Jahjaga, Presidente e Republikës së Kosovës, 21.04. 2012.
10. The Kosovo Policy Action Network. Appeal to the civil society and to citizens of Prizren to protect cultural heritage, 31.01.2012.
11. Koalicioni i OJQ-ve. Deklaratë për Media, Konkluzionet e tekimit të shoqërisë civile të Prizrenit me palët relevante rreth projekt-ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, 26.08.2011.
12. Koalicioni i OJQ-ve. Komunikatë për Media, 24.01.2012.
13. Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor. Deklaratë e Komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, Kuvendi i Republikës së Kosovës, 29.11.2011.

## Literatura:

AGARIN, T. (2010) *A Cat's Lick: Democratisation and Minority Communities in the Post-Soviet Baltics*. Amsterdam: Rodopi.

ARRAIZA, J. M. (2014) *A Matter of Balance. Cultural Heritage, Property Rights and Inter-Ethnic Relations in Kosovo. Property and Investment in Jus Post Bellum. Clarifying Norms, Principles and Practices*. The Hague.

BACCHI, C. and EVELINE J. (2010) „Approaches to Gender Mainstreaming: What's

the Problem Represented to be?“, në Bacchi C., Eveline J. (red.), *Mainstreaming Politics: Gendering Practices and Feminist Theory*. Adelaide: University of Adelaide Press, fq. 111–139.

BATESON, G. (1972) A Theory of Play and Fantasy, në Bateson G. (red.) *Steps to an Ecology of Mind: Collected Essays in Anthropology, Psychiatry, Evolution, and Epistemology*. Chicago: University of Chicago Press, fq. 177–193.

BENFORD, R.D, SNOW D.A (2000) Framing Processes and Social Movements: An Overview and Assessment, *Annual Review of Sociology*. 26 (1), fq. 611–639.

CIANETTI, L. (2014) Granting Local Voting Rights to Non-Citizens in Estonia and Latvia: The Conundrum of Minority Representation in Two Divided Democracies, *Journal of Ethnopolitics and Minority Issues in Europe*. 13 (1), fq. 86–112.

EC MA NDRYSHE (2013) *Erroneous. An Analysis of Numerous and Continuous Faults in Cultural Heritage*. Prishtina: Forum 2015, Kosovo Foundation for Open Society.

GAMSON, W.A. (2004) Bystanders, Public Opinion, and the Media. Në Snow D., Soule S. dhe Kreisi H. (red.) *Blackwell Companion to Social Movements*. Malden: Blackwell, fq. 242–261.

GAMSON, W.A. and MODIGLIANI A. (1989) Media and Public Opinion on Nuclear Power: A Constructionist Approach. *American Journal of Sociology*. 95, fq. 1–37.

GOFFMAN, E. (1974) *Frame Analysis*. New York: Harper & Row.

LONCAR, J. (2015) Power-sharing in Kosovo: Effects of Ethnic Quotas and Minority Veto. ë Teokarevic J., Baliqi B. dhe Surlic S. (red.) *Perspectives of a Multiethnic Society in Kosovo*. Belgrade: Youth Initiative for Human Rights, fq. 359–373.

MEIER, P. (2008) Critical Frame Analysis of EU Gender Equality Policies: New Perspectives on the Substantive Representation of Women. *Representation*. 44 (2), fq. 155–167.

OSCE (2014) *Challenges in the Protection of Immovable Tangible Cultural Heritage in Kosovo*. Organization for Security and Co-operation in Europe, Mission in Kosovo.

PREIS, A.B. and MUSTEA C.S. (2013) *The Role of Culture in Peace and Reconciliation e disponueshme në: <http://www.unesco.org/new/fileadmin/MULTIMEDIA/HQ/CLT/images/PeaceReconciliationENG.pdf> [e parë më 22.03.2015]*.

SASSE, G. (2008) The politics of EU conditionality: the norm of minority protection during and beyond EU accession. *Journal of European Public Policy*. 15(6), fq. 842–860.

SCHULZE, J.L. (2010) Estonia caught between East and West: EU conditionality, Russia's activism and minority integration. *Nationalities Papers*. 38 (3), fq. 361–392.

SNOW, D.A. and BENFORD R.D. (1988) Ideology, Frame Resonance, and Participant Mobilization. në Klandermans B., Kriesi H. dhe Tarrow S. (red.) *From Structure to Action: Social Movement Participation Across Cultures*. Greenwich: JAI Press, fq. 197–217.

TOTH, N. and VIZI B. (2014) Obligations Arising from Public International Law Relating to the Rights of Minorities – Some Observations on the Case of Kosovo. *Pecs Journal of International and European Law*. (1), fq. 88–97.

VAN GORP, B. (2007) The Constructionist Approach to Framing: Bringing Culture Back. *Journal of Communication*. 57 (1), fq. 60–78.

VERLOO, M. and LOMBARDO E. (2007) Contested Gender Equality and Policy Variety in Europe: Introducing a Critical Frame Analysis Approach. në Verloo M. (red.) *Multiple Meanings of Gender Equality: A Critical Frame Analysis of Gender Policies in Europe*. Budapest,

New York: Central European University Press. fq. 21–51.

**Përktheu: Anton Berishaj**

**Jelena Lončar**

Faculty of Political Sciences

University of Belgrade and University of York

## **Cultural heritage in Kosovo: Strengthening exclusion through inclusive legislation**

### **Abstract:**

This paper focuses on inter-ethnic relations in Kosovo by analysing the process of adoption of two relevant minority-laws in Kosovo: the Law on Historic Centre of Prizren and the Law on the Village of Velika Hoča/ Hoçë e Madhe. Using critical frame analysis, the paper examines what is going on during legislative process, what representations are made of the issues on the agenda, beneficiaries of the law and other actors involved in the process. The findings show that even minority favourable legislation can serve as an exclusion mechanism. While legislative framework in Kosovo guarantees full protection of minority rights, political institutions in Kosovo encourage ethnic cleavages and inter-ethnic tensions.

---

### **Keywords:**

inter-ethnic relations, cultural heritage, legislative process, Kosovo.

